



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 11.03.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 09.03.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Bashkimi&Meti" për aktivitetin: "Mirembajtja e rrugeve rurale" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-7786-211 nxjerr:

VENDIM

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Bashkimi&Meti" e datës 09.03.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirembajtja e rrugeve rurale" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-7786-211, kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 03.03.2020*, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.

1. **Vërtetohet** *Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 03.03.2020;*
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "**Bashkimi&Meti**" me datë 09.03.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirembajtja e rrugeve rurale" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-7786-211.

Autoriteti Kontraktues, me datë 11.03.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar Rregullat për tenderet jonormalisht të ulet sa i përket kushtit të dyte sipas rregullave për tenderet jonormalisht të ulet është i pa bazuar, pasi që mesatarja e tendereve të pranuar sipas ketyre rregullave pjestohet me pragun 30%, respektivisht me 1/3 dhe në këtë rast është si vijon 77,423.27 €/1.3 është 59,556,36 euro, e jo si që keni pretenduar ju në kërkesën tuaj 23,226.98 €.

-Pretendimi tjetër se në sqarimin tuaj keni dorëzuar një faturë me gabim teknik është pasqyruar i pa bazuar, pasi që ajo faturë nuk ka elementin kryesor-çmimin për njësi që do të duhej krahasuar me çmimet e tenderit tuaj.

Bazuar në sqarimet e dhëna për pretendimet tuaja u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Shtojcë: Formulari i KRPP-Rregulat për tenderet jonormalisht të ulët.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit



Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në pajtim me Nenin 87, paragrafin 2, nën-paragrafin 2.8 dhe nenin 61, paragrafin 6, të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, adopton Rregullat që plotësojnë dhe japin sqarime për tenderët jo-normalisht e ulët.

Neni 1 Qëllimi

1.1 Qëllimi i këtyre Rregullave është që të epen sqarime për Autoritetet Kontraktuese në lidhje me Konceptin e tenderit jo-anomalisht të ulët i cili i referohet atyre tenderëve që, në shikim të parë, duken për autoritetin kontraktues si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe, në përputhje me rrethanat, ka gjasa për një performancë të keqe të kontratës.

1.2 Në çdo rast, kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulët, **ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta** pa përdorur një procedurë *inter partes* me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët.

Neni 2 Termet e përdorura

Termet e përdorura në këta Rregulla kanë të njëjtin kuptim siç përmendën në Nenin 4 (Definicionet) të Ligjit mbi Prokurimin Publik Nr 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Neni 3 Informatat e përgjithshme

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të **gjitha kushtet e mëposhtme**:

- i. çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm**;
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**;
- iii. janë dorëzuar të paktën **3 (tre) tenderë**.

3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tilla dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

Neni 4
Procedura e shqyrtimit (inter partes)

4.1 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit 3.1 ose 3.2 të këtyre rregullave, një tender i tillë **nuk mund të refuzohet** pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktojnë tenderin veçanërisht të ulët.

4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormisht i ulët, Autoriteti Kontraktues **duhet të kërkojë me shkrim** nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbatim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja **"Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët"**.

4.3 Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetit Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet.

4.4 Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të marrë në konsideratë:

- 4.4.1 ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
- 4.4.2 çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
- 4.4.3 çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
- 4.4.4 origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

4.5 Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 4.4 të këtyre rregullave, Autoriteti kontraktues duhet të marrë në konsideratë:

- 4.5.1 elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet.

4.6 Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose:

- 4.6.1 Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose
- 4.6.2 Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, **"Njoftim për refuzim të tenderit abnormisht të ulët"**, brenda dy dite nga data e vendimit.

4.7 Tenderuesi në fjalë do të informohet për rezultatin final të vlerësimit.

SHEMBULL 1

Nr.	Lot 1			
	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta	Pranuar 6 oferta		
2		1	2,021,514.20	
3		2	1,334,220.45	
4		3	2,151,997.25	
5		4	1,899,832.59	
6		5	2,494,303.84	
7		6	1,987,499.90	
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7)	11,889,368.23	
9		mesatarja (C8/6)	1,981,561.37	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	1,524,277.98	ne ketë rast vetëm oferta 2 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11	kushti 3 – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	pragu 10% (oferta e dyte /1.1)	1,727,120.54	ne ketë rast oferta 2 përmbush edhe kushtin e trete

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Oferta e dyte plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih prapun ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih prapun C11
Konkludim	Oferta me nr. rendor 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet	

SHEMBULL 2

Nr.	Lot 2			
	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 4 oferta	Pranuar 4 oferta		
2		1	2,684,598.09	
3		2	1,888,880.48	
4		3	1,878,488.51	
5		4	2,497,038.42	
6				
7				
8		Total (C2+C3+C4+C5)	8,949,005.50	
9		Mesatarja (C8/4)	2,237,251.38	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	1,720,962.60	ne ketë rast asnjë oferte nuk përmbush kushtin e dyte prandaj NUK vazhdohet me kushtin e trete

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 4 oferta.
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Asnjë oferte nuk plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me pak se 30% me i ulët se mesatarja e tenderëve. Shih prapun ne kolonën C10
Konkludim	Asnjë oferte nuk mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet sipas paragrafit 3.1 por AK mund te vazhdoj sipas paragrafit 3.2 te rregullores	